



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 122, datë 06.03.2024

PËR

DEKLARIMIN E PËRFUNDUAR, PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3 e 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, në përfundim,

VENDOSI:

I. Të deklarojë të përfunduar, pa një vendim përfundimtar, shqyrtimin e kërkesave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, si më poshtë:

1. Kërkesës nr. 16023 prot., datë 07.11.2023, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditës {...}, e paditur: {...}, {...} etj me objekt: “Detyrim shpërbllim dëmi...”
2. Kërkesës nr. 16923 prot., datë 16.11.2023, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditëse {...}, palë të paditur {...}, {...} me objekt: “Detyrim njohje page referuese...”
3. Kërkesës nr. 17245 prot., datë 17.11.2023, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditëse {...}, palë të paditur {...}, {...} me objekt: “Detyrim pagim diferencat e pagës ...”,

4. Kërkesës nr. 17271 prot., datë 21.11.2023, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditëse {...}, palë të paditur {...}, {...} me objekt: “Detyrim rillogaritje të pagës ...”,

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR